



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJETIKES  
DREJTORIA E PERGJITHSHME E SHERBIMEVE TREGETARE

URDHER

Nr. 167 Date 17.04.2007

PER  
NDRYSHIMIN E KAPITALIT TE SH.A "TRAJTIMI I STUDENTEVE"  
ELBASAN

Drejtuar: Sh.A "Trajtimi i Studenteve" Elbasan

Ne mbeshtetje te nenit 102 pika 4 te Kushtetutes te Republikes se Shqiperise dhe ne baze te paragrafit te pare te nenit 2 te Ligjit Nr. 8237, date 01.09.1997 "Per disa ndryshime ne Ligjin Nr. 7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare", ndryshuar me Dekretin Nr. 1195, date 14.08.1995, Ligjin Nr. 8099, date 28.03.1996, Dekretin Nr. 1631, date 01.11.1996, Ligjin Nr. 8885, date 22.04.2002 si dhe Ligjin Nr. 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", me cilesine e aksionerit te vetem te sh.a "Trajtimi i Studenteve" Elbasan,

URDHEROJ:

1. Zmadhimin e kapitalit te Sh.A "Trajtimi i Studenteve" Elbasan, per vleren e truallit.
2. Kapitali themeltar i sh.a " Trajtimi i Studenteve" Elbasan, pas ndryshimit te mesiperm behet 337 000 000 leke, i barabarte me 337 000 aksione, me vlere nominale 1000 leke secili.
3. Ngarkohet Drejtoria e Sh. A. " Trajtimi i Studenteve " Elbasan, per kryerjen e veprimeve perkatese ne perputhje me parashikimet e nenit 33 te ligjit 7667 date 28.01.1993 "Per regjistrin tregetar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare".

Ky Urdher hyn ne fuqi menjehere.

MINISTRI

GENJEROLI

Adresat: Blvd. "Deshmoret e Kombit" Nr.2  
E-mail: [kabur@mete.gov.al](mailto:kabur@mete.gov.al)  
Internet: <http://www.mete.gov.al>

Tel: +355 4 226241  
Tel: +355 4 223158  
Fax: +355 4 234052

Wk. 43 Prad dt. 02.05.2007

MINISTRISË SE EKONOMISË  
*Drejtoria e privatizimit të ndermarjeve të vogla e të mesme*

**RAPORT I**

**EKSPERTIT KONTABEL TE AUTORIZUAR**

*Per transformimin e „Ndermarjes Trajtimit të Studenteve” Elbasan në Shoqeri Anonime.*

Une Andon Kristo, ekspert kontabel i autorizuar me licence nr.05, i caktuar nga Ministri i Ekonomisë me Urdherin nr.404, datë 16.11.2004 për verifikimin dhe vertetimin e bilancit të reformuar të „Ndermarjes së Trajtimit të Studenteve” Elbasan, kam nderin të paraqes raportin tim për sa vijon:

Për periudhën prej 18.11. -2 9.12.2004 unë kam ndjekur nga afër punën e komisionit të Ndermarjes për inventarizimin dhe vlersimin në zbatim të detyrave që rrjedhin nga VKM nr.194, datë 20.3.1998 dhe Udhezimin të Ministrisë Ekonomisë Nr.1, datë 15.5.1998 „Për kriteret e percaktimit të kapitalit themeltar të shoqerive shtetërore që do të krijohen nga shndërrimi i Ndermarjeve Shtetërore në Shoqeri Tregëtare.” Rregjistrimet për percaktimin e kapitalit themeltar janë kryer në mënyrë të plote dhe të rregullt.


**Kapitali themeltar i transformuar ka vlerën 174.440.000.- Leke.**

**Në këtë shumë nuk përfshihet vlera e truallit, për arsye të vonësës në procedurat e percaktimit të çmimit të tij nga ana e Urbanistikës së Bashkisë Elbasan, gjë që do të bëhet në një periudhë të mëvonshme me akt ekspertimi të vecantë.**

Shenjë se gent-plani i sipërfaqes është hartuar dhe miratuar.

*Bilanci i celjes i shoqerisë që do të krijohet si pasoje e transformimit të Ndermarjes së Trajtimit të Studenteve jep një pamje besnike të pasurisë dhe të gjendjes financiare të saj.*

- > Trualli përbehet nga sipërfaqja që zënë ndërtesat e konvikteve dhe menca, për të cilat janë hartuar gent-planet të firmosura nga Drejtori i Ndermarjes si dhe nga Urbanistika e Bashkisë Elbasan. Është bërë edhe percaktimi i koeficientit të vendndodhjes së tij.
  - > Për ndërtesat është kryer inventari i tyre, është percaktuar vlera e amortizimit për çdo objekt si dhe duke u nisur nga koeficienti i çmimit të muajit të fundit , 10.9016 si dhe koeficientin e vendndodhjes + 70%, është percaktuar vlera e reformuar fillestare si dhe ajo e amortizimit si dhe shtesat përkatëse si pasoje e vlersimit për efekt reformimi.
  - > Për makineri e pajisje (kaldaja), mjetet e transportit, inventarin ekonomik, është vepruar gjithashtu (pa koeficientin e vendndodhjes).
- Për pasoje shtesat e vlerës fillestare si dhe amortizimit për efekt reformimi paraqiten sipas grupeve të aktiveve të qëndrueshme:



	S h t e s a t	
	Vleftes fillestare	amortizimit
Ndertesat	178755420	56588402
Makineri paisje	4069052	2101803
Mjete transporti	2085600	2042191
Paisje zyre	4445302	2007316
Totali shteses:	189355374	62739712

> Per kerkesat debitore. Nu ka te tilla.

- Per materialet paraqiten me vleren fillestare. Inventari i imet paraqiten me vlere te mbetur (minus konsumin e llogaritur).
- Per likujditetet paraqiten ne dy poste : a- likujditete ne banke si dhe b-likujditete ne udhetim, qe perbehen nga fondet e celura ne fund te vitit por pa kaluar ne banke.
- Ne postin subvencione per investime paraqitet paraqitet vlere e subvencioeve per investime te pa amortizuara.
- Detyrimet qe ka ndermarja ndaj te tretteve perbehen nga detyrimi ndaj furnitoretvet per 1590360.50 leke, detyrimi ndaj puonjesve per 446190 leke, detyrimi per sigurimet shoqerore 374035 leke. Detyrime ndaj tatim taksave per 1499815 leke, si dhe detyrime te tjera per 1445000 leke, te cilat jane te rakorduara e te pagueshme.
- Ne grupin c te pasivit ne postin llogari te tjera paraqiten ta ardhura te arketuara per llogari te vitit te ardhshem per 10115000. Leke

>Ne levizjet e llogarise se veprimit 171 paraqiten :

Ne debi : shtesa e amortizimit per 62739712.- leke.

Ne kredi: rezerva e kapitalit per 2500656 leke, rezerva e zhvillimit per 8694189 Leke, rezerva e shperblimit suplimentar per 46800 leke, rezerva per ndihma te menjihershme per 1119985 leke, fimi i mbetur nga viti 2003 per 3677665 leke, shtesa e vleres fillestare per 189355374 leke.


Mbyllja e llogarise se veprimit eshte bere duke kaluar diferencen e saj ne llogarime 101 kapitali per 121254002 leke si dhe ne llogarime e rezerves nga rivlersimi per 21400955 Leke.

> Lista e komisionit vleresimit eshte e miratuar nga Drejtori i Ndermarjes.

> Ne dosje jane te gjitha materialet e parashikuara, dhe ne aq ekzemplare, sipas Vendimit te Keshillit Ministrave nr.194, date 20.3.1998 dhe udhezimit te Ministrise Ekonomise Nr.1, date 15.5.1998.

EKSPERTI KONTABEL I AUTORIZUAR  
LICENCA NR.05  
(ANDON KRISTO)

Elbasan, me 29.12.2004



## RAPORT I

### EKSPERTIT KONTABEL TE AUTORIZUAR

Une Andon Kristo, ekspert kontabel i autorizuar me licence nr.05, i caktuar nga Ministri i Ekonomise me urdherin nr.404, date 16.11.2004 per verifikimin dhe vertetimin e bilancit te reformuar te Ndermarjes se Trajtimit te Studenteve Elbasan, kam nderin te paraqes raportin tim per sa vijon:

Per periudhen prej 18.11. -2 9.12.2004 une kam ndjekur nga afer punen e komisionit te Ndermarjes per inventarizimin dhe vlersimin ne zbatim te detyrave qe rrjedhin nga VKM nr.194, date 20.3.1998 dhe Udhezimin te Ministrise Ekonomise Publike dhe Privatizimit nr.1, date 15.5.1998 „Per kriteret e percaktimit te kapitalit themeltar te shoqerive shteterore qe do te krijohen nga shnderrimi i Ndermarjeve Shteterore ne Shoqeri Tregtare.”

Rregjistrimet per percaktimin e kapitalit themeltar jane kryer ne menyre te plote dhe te rregullt.

**Kapitali themeltar i transformuar ka vleren 174.440.000.- Leke.**

**Ne kete shume nuk perfshihet vlera e truallit, per arsye te voneses ne procedurat e peercaktimit te cmimit te tij nga ana e Urbanistikes se Bashkise Elbasan, gjegje qe do te behet ne nje periudhe te mevonshme me akt ekspertimi te vecante.**

Shenoj se gentplani i siperfaqes eshte hartuar dhe miratuar.

Bilanci i celjes i shoqerise qe do te krijohet si pasoje e transformimit te Ndermarjes se Trajtimit te Studenteve jep nje pamje besnike te pasurise dhe te gjendjes financiare te saj.

Eksperti kontabel i autorizuar licenca nr.05  
(Andon Kristo )

Elbasan, me 29.12.2004

